

STUDIMI

Kalaja e Krujës, Ministria Margariti firmos marrëveshjen për projektin e stabilizimit të shkëmbit

Ministria e Kulturës, Elva Margariti firmosi marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë "Urbatrans" sh.a, përfaqësuar nga z. Arben Petto, për sponsorizimin e projektit "Stabilizim i shpatit të pjesës verilindore të Kalasë së Krujës". Falë kësaj marrëveshjeje mundësohet studimi gjeologjik dhe hartimi i projektit të plotë për përf forcimin e strukturës shkëmbore, ku ngrihet kulla e Sahatit, në Kalanë e Krujës, i cili pësoi dëmtime prej tërmetit të 26 nëntorit.

Ndërkaq, specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore kanë marrë pjesë gjatë realizimit të shpimeve gjeologjike me sondë në strukturën shkëmbore në pjesën ku ngrihet Kulla e Sahatit, në kalanë e Krujës. Sipas IKTK-së ky studim do të ndihmojë në hartimin e projektit të ndërhyrjes për përf forcimin e strukturës. Nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës, në vijim të tërmetit të 26 nëntorit 2019, pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore janë ngritur grupe teknike për inspektime në pasuritë kulturore si dhe në institucionet e artit, kulturës dhe muzetë në administrimin e Ministrisë së Kulturës.

BASHKËPUNIMI

Ministria Margariti takon Zv.ministren italiane, Orrico, diskutojnë fushat e bashkëpunimit

Ministria e Kulturës, Elva Margariti zhvilloi një takim në Tiranë, me Zëvendësinistren Italiane të Kulturës, Anna Laura Orrico, ku diskutuan mbi bashkëpunime të ardhshme në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, si edhe projekte të përbashkëta në kinematografi apo për sa i përket fushës së arteve pamore, operistikës dhe librit. Pasi vlerësoi marrëdhëniet e mira mes dy vendeve, Ministria e Kulturës, Elva Margariti i parashitroi Zv.ministres italiane, disa nevojat dhe fushat e bashkëpunimit. Ministria Margariti u shpreh se në fushën e trashëgimisë materiale ndihet nevoja për formimin e ekspertëve në fushën e arkeologjisë dhe të restaurimit të pikturës murale. Zv. Ministria italiane Anna Laura Orrico shprehu gatishmërinë për të intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Shqipërinë, në fushën e kulturës. Sipas saj, dy vendet tona i përkasin të njëjtës zonë, asaj mesdhetare, identiteti e së cilës duhet ruajtur. Ajo u shpreh se e sheh shumë të mundshëm bashkëpunimin, sidomos në fushën e digjitalizimit të trashëgimisë kulturore materiale dhe në fushën e kinematografisë, për të cilat ajo është përgjegjëse. Sipas saj teknologjia është efikase për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore të brezat e rinj, të cilët janë edhe përdoruesit kryesorë të teknologjisë.

THIRRJA

Hapen aplikimet për projektet kulturore e artistike për vitin 2020

Edhe këtë vit Ministria e Kulturës hapi thirrjet për mbështetjen financiare të projekteve kulturore. Kjo thirrje u drejtohet organizatave joftimprurëse, personave fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre promovimin dhe edukimin në fushat e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Kjo thirrje synon mbështetjen e projekteve që zhvillohen ekskluzivisht ose kryesisht në Shqipëri. Projekt-propozimet që do të paraqiten duhet t'i përmbahen kritereve të vendosura nga Ministria e Kulturës, në mbështetje të politikave të saj për zhvillimin e artit dhe kulturës, nën moton "E ardhmja është origjinë". Ato duhet të realizohen brenda periudhës 1 mars - 5 dhjetor të vitit 2020. Thirrja u hap në 16 janar dhe do të mbyllet në 14 shkurt. Procesi i vlerësimit të projekt-propozimeve kalon në dy faza. Në të parën kolegjiu do të përzgjedhë ato projekte, që plotësojnë kriteret e vendosura për të kaluar në fazën e dytë. Ndërsa në fazën e dytë, projektet e përzgjedhura do të prezantohen në një audicion të hapur. Në fund, kolegjiu do të përzgjedhë edhe fituesit për këtë thirrje. Të gjithë aplikuesit, që kalojnë në fazën e dytë do të njoftohen në datën 25 shkurt, ndërsa audicionet për përzgjedhjen e projekteve fituese, do të zhvillohen në datën 27 shkurt 2020.

PROBLEMET

Libri në dekadën e re, botues e shkrimtarë ndajnë problemet me Ministren e Kulturës

Në fillim të një viti të ri, një dekadë të re dhe në prag të ndarjes së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë, Ministria e Kulturës, Elva Margariti zhvilloi një takim me njerëz të letrave, shkrimtarë, botues, studiues. Qëllimi i këtij takimi ishte evidentimi i shqetësimeve të tyre dhe gjetja e rrugës që të çon drejt zgjidhjes. Botuesit u shprehën të shqetësuar për çështjen e taksës mbi librin, si dhe furnizimin me libra të bibliotekave të shkollave, titujt e të cilëve përcaktohen nga Ministria e Arsimit. Ata u shprehën se ky është një ngërç, që duhet zgjidhur pasi ndikon në formimin e brezit të ri. Pasi renditi disa nga nismat e marra nga Ministria e Kulturës, si hapja e Fondit për Krijimtarinë për Fëmijë, hapjen e Fondit të Përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhë të huaja, organizimin e Tetorit të Librit dhe së fundi edhe rikthimin e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë, Ministria Margariti u shpreh se me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, problemet e tyre do të gjejnë adresim dhe zgjidhje edhe më të shpejta. Kjo Qendër pritet të nisë punë së shpejti, edhe me prezantimin zyrtar të drejtores së QKLL.

VENDIMET

Nga pikturat murale të Shën Mërisë në Sinjë, te Ura e Mesit në Shkodër, miratohen projektet e restaurimit

Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të varësisë, vijon punën për ruajtjen, restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore materiale. Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka miratuar një sërë projektesh restaurimi për monumente të rëndësishme, të shtrira në gjithë Shqipërinë. Një ndër ta është projekti "Restaurim i pikturës murale në kishën e Shën Mërisë", Sinjë, Berat. Projekti i hartuar nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Berat parashikon ndërhyrje konservuese dhe restauruese në pikturën murale të kishës.

Një tjetër projekt i miratuar është edhe ai i restaurimit: "Ura e Shkinës", Blinisht, i hartuar nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Shkodër, i cili parashikon ndërhyrje konservuese dhe restauruese në elementët konstruktivë dhe estetikë të urës. Rëndësi të veçantë paraqet restaurimi i Urës së Mesit në Shkodër. Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka miratuar projektin e restaurimit, i cili po ashtu parashikon ndërhyrje konservuese dhe restauruese në elementët konstruktivë dhe estetikë të urës.